



## **VENDIM MBI PRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 1 korrik 2014**

**Numri i lëndës: 2013-03**

**Goran Becic**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut përmes mjeteve elektronike, në përputhje me rregullën 13 të rregullores së punës, më 1 korrik 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar në Panel më 27 maj 2013.

2. Më 7 qershor 2013, Paneli ka vendosur të njoftoj shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë rreth ankesës, duke e ftuar atë që të parashtrijë vërejtjet me shkrim rreth ankesës. Vërejtjet ishin pranuar në 15 gusht 2013. Më pas ato u janë komunikuar ankuesit për komente. Ankuesi i ka ofruar komentet e tij më 8 shtator 2013 dhe ka dërguar komente shtesë më 12 shtator 2013. Këto komente janë përkthyer dhe u janë dërguar ShM për informim më 10 tetor 2013.
3. Më 27 nëntor 2013, Paneli ka vendosur që t'i komunikoj ShM një deklaratë të zgjeruar të fakteve, duke e ftuar atë të paraqesë vërejtje shtesë me shkrim. Më 9 dhjetor 2013, ankuesi ka njoftuar Panelin rreth zhvillimeve të mëtejshme në lëndën e tij. Më 26 dhjetor 2013, ShM ka dorëzuar vërejtje të tjera. Ankuesi ka dorëzuar komente të tjera më 9 shkurt 2014 dhe më 27 maj 2014.

## II. FAKTET

4. Ankuesi posedon një banesë në Prishtinë. Ankuesi pohon se që nga viti 1999 ai nuk ka qenë në gjendje të merr posedimin e banesës së tij. Në vitin 2004, njëfarë S.H., i cili banonte në mënyrë të paligjshme në atë banesë ishte dëbuar prej banesës në bazë të një "*Vendim nga Habitati* [Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore] (HPCC/D/87/2003/C i datës 29.08.2003) përmes së cilit është konfirmuar se [ankuesi është] *pronar legjitim i banesës*".
5. Pavarësisht prej këtij vendim, ankuesi nuk ka arritur të rimarrë në posedim banesën e tij. Në disa raste, uzurpatorë të ndryshëm kishin zënë banesën e tij dhe më pas e kishin braktisur atë.
6. Në vitin 2009, gjatë një periudhe të shkurtë kohore kur banesa kishte mbetur e lirë, ankuesi kishin arritur ta rinovonin atë.
7. Më 26 gusht 2009, gruaja e ankuesit kishte shkuar në banesë dhe kishte zbuluar se përsëri banesa ishte e zënë në mënyrë të paligjshme. Me atë rast, dera e banesës dyshohet se ishte hapur nga vajza e një R.Q., e cila ka thënë se kjo banesë ju ishte "ndarë" R.Q.-së nga anëtarët e stacionit policor nr. 4 "Dardania" në Prishtinë. Ankuesi pohon se zyrtarët policorë nga stacioni policor nr. 4 ja kishte lëshuar me qira banesën R.Q.-së.
8. Ankuesi pohon se R.Q. është pjesëtar i policisë së Kosovës dhe ai e kishte marrë në posedim banesën me miratimin e shefit të stacionit policor nr. 4.
9. Më 14 shtator 2009, përfaqësuar nga një avokat i "Këshillit danez për refugjatë", ankuesi kishte ngritur padi penale në prokurorinë publike komunale në Prishtinë kundër R.Q. dhe anëtarëve të PK-së nga stacioni policor nr. 4. Më pas, ankesa ishte përfaqësuar nga avokatët e OJQ-së: "Mbështetje e mëtejshme për refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit në Serbi". Ankuesi ka pohuar se më 6

nëntor 2009, prokurori publik kishte kërkuar nga policia të mbledh informata për ta identifikuar kryesin e veprës penale.

10. Ankuesi pohon se ai ka kontaktuar EULEX-in përmes postës elektronike më 29 nëntor 2009 dhe e ka njoftuar atë lidhur me rastin e tij. Ai ishte referuar tek një pjesëtar i personelit të EULEX-it (M.M.) dhe ishte njoftuar se ankesa e tij ishte dërguar tek disa njësi në kuadër të misionit të EULEX-it. Më 13 dhjetor 2009 ankuesi ka njoftuar M.M. lidhur me lëndën e tij dhe në mënyrë të veçantë lidhur me katër përpjekje të parashtruesit të ankesës për të raportuar çështjen në polici (më 4 qershor 2008, 14 tetor 2008, 26 gusht 2009 dhe 10 tetor 2009), të cilat nuk kanë dhënë asnjë rezultat. Më 5 janar 2010 ankuesi ka marrë një përgjigje nga M.M., i cili i ka ofruar atij të dhënat e personit kontaktues, pra shefit të zyrës ndërlidhëse të gjykatës në Mitrovicë, duke i sugjeruar që ta kontaktoj atë.
11. Ankuesi ka paraqitur postën elektronike nga M.M., ku thuhet *ndër të tjera se "EULEX-i është i interesuar në rastet e keqpërdorimeve eventuale në sistemin e gjykatës dhe është në kuadër të mandatit tonë për të përmirësuar mbrojtjen e qytetarëve dhe të drejtat e tyre para gjykatave"*. Ankuesi është këshilluar që të kontaktoj shefin e zyrës ndërlidhëse të gjykatës në Mitrovicë pasi: *"vlerësimi i saj lidhur me nevojën që EULEX-i të ndërhyjë mund të jetë vendimtar"*.
12. Përpjekjet e mëtejshme nga ana e ankuesit për t'ju drejtuar zyrtarit që ishte sugjeruar si dhe kontaktit fillestar brenda EULEX-it, nuk kanë dhënë asnjë përgjigje.
13. Më në fund, më 6 maj 2010, ankuesi ka qenë në gjendje të paraqesë një ankesë në stacionin policor nr. 4 me ndihmën e një avokati.
14. Pretendohet se më 30 gusht 2010, ankuesi ka parashtruar një letër në zyrën e prokurorisë publike komunale duke kërkuar që autoritetet duhet të ndërmarrin masa në lidhje me rastin e tij dhe duhet t'i përgjigjet atij me shkrim. Ankuesi thekson se ai nuk ka marrë asnjë përgjigje.
15. Pas kësaj, ankuesi ka kontaktuar prapë EULEX-in përmes postës elektronike në fillim të janarit 2012. Ankuesi ka paraqitur në Panel një letër si përgjigje nga bashkërenduesi për të drejtat mbi pronë të EULEX-it të datës 14 shkurt 2012, duke e këshilluar atë në lidhje me mjetet juridike në dispozicion dhe duke treguar se kjo përgjigje ju është shpërndarë organit të duhur të EULEX-it që është përgjegjës për sigurimin e mbështetjes ndaj zyrës së prokurorisë komunale në Prishtinë, shefit të zyrës së prokurorisë publike komunale në Prishtinë, si dhe ushtruesit të detyrës së drejtorit të zyrës së këshillit disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
16. Më 7 mars 2012, ankuesi ka marrë një letër nga zyra e këshillit disiplinor, ku njofton ankuesin se prokurori i parë i caktuar për rastin ishte zëvendësuar në vitin 2010 dhe se më 28 shkurt 2012 rasti ju

ishite caktuar një tjetër prokurori. Ankuesi pohon se nuk ka pasur përparim në lëndën e tij.

17. Më 30 gusht 2012, ankuesi përsëri ka ju ka drejtuar bashkërenduesit për të drejtat mbi pronë në EULEX, duke kërkuar ndihmë. Ankuesi ka marrë një përgjigje nga bashkërenduesi për të drejtat mbi pronë në EULEX-it më 20 shtator 2012, duke siguruar disa këshilla lidhur me mjetet juridike të mundshme dhe gjithashtu duke e njoftuar atë se lënda ju ishte referuar organit përgjegjës të EULEX-it me qëllim të informimit.
18. Më 12 shtator 2012, prokuroria komunale e Prishtinës ka zhvilluar një intervistë me R.Q., i cili dyshohej se ka pranuar se ai ishte duke shfrytëzuar banesën, ku në mënyrë të jashtëligjshme kishte hyrë pasi ja kishte thyer derën.
19. Më 28 janar 2013, ankuesi edhe një herë iu ka drejtuar EULEX-it, pasi gjoja se atij iu ishte kërkuar nga R.Q. që t'i paguante atij 5.000 euro si parakusht që ai të lironte banesën. Ankuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje nga EULEX-i.
20. Më 1 prill 2013, përfaqësuesi ligjor i ankuesit i ka shkruar zyrës së prokurorisë themelore publike dhe i ka kërkuar që të nis procedurat penale në bazë të fakteve të mbledhura dhe pranimit nga ana e R.Q. Ai nuk ka pranuar asnjë përgjigje.
21. Më 11 maj 2013, ankuesi iu është drejtuar zyrës së këshillit disiplinor të Prishtinës. Ai ka marrë një përgjigje nga zyra e këshillit disiplinor më 16 gusht 2013, që ka deklaruar se lënda kundër R.Q. (propozim për aktakuzë) ishin paraqitur nga zyra e prokurorisë komunale në gjykatën komunale në Prishtinë më 5 korrik 2011 dhe se ajo ishte pritje pranë kësaj gjykate. Më tej, zyra e këshillit disiplinor nuk ka përcaktuar asnjë bazë për nisjen e hetimeve disiplinore ndaj sjelljes joprofesionale prokuroriale të prokurorit në lëndën e R.Q.
22. Më 15 gusht 2013, ankuesi ka marrë një letër nga zyra e prokurorisë themelore të Prishtinës. Atij iu ishte kërkuar që ta plotësoj lëndën e tij me dokumente shtesë, duke përfshirë edhe dëshminë e pronësisë së banesës. Më tej, atij iu ishte kërkuar të paraqesë vendimin e komisionit për kërkesa pronësore banesore (shih par. 4 më lartë). Ankuesi ka siguruar dokumentet përkatëse dhe më tej ka deklaruar se ai tashmë i kishte paraqitur këto dokumente kur kishte paraqitur padinë penale lidhur me këtë lëndë.
23. Në një datë të papërcaktuar gjatë vjeshtës së vitit 2013, ekipi mobil në çështjet e gjyqësorit nga divizioni i përforsimit të EULEX-it ka marrë përsipër monitorimin e procedurës penale që është në pritje pranë gjykatës themelore në Prishtinë, e cila kishte qenë e iniciuar në një datë të papërcaktuar, me sa duket në vjeshtë të vitit 2013.

24. Më 16 dhjetor 2013, gjykatësi i gjykatës themelore ka gjetur të akuzuarin fajtor dhe i ka shqiptuar një dënim me kusht prej tre muaj burgim, kurse edhe duke e urdhëruar që ta liroj pronën brenda 30 ditëve nga data e vendimit.

#### **Ankesat**

25. Ankuesi pohon se EULEX-i nuk ka arritur të reagojë në mënyrë të duhur rreth lëndës së tij dhe prandaj ka shkelur të drejtat e tij të njeriut. Mund të nxjerrët se ankuesi ankohet në bazë të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj) në lidhje me nenin 14 të Konventës dhe në bazë të Nenit 13 të Konventës.

#### **IV. LIGJI**

26. Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë KEDNj dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KEDCP), të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga organet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

#### **LIGJI PËRKATËS NË FUQI**

##### **Veprimi i përbashkët**

27. Pjesët përkatëse të nenit 2 dhe 3 të veprimit të përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË (më tutje si: Veprimi i Përbashkët), vijon si më poshtë:

##### **Neni 2 Deklarata e Misionit**

EULEX-i në Kosovë do të ndihmojë institucionet e Kosovës, organet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikrat më të mira evropiane.

EULEX-i në KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndhimë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

##### **Neni 3**

##### **Detyrat**

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

(d) të sigurojë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar/ekonomik dhe krimeve tjera të rënda të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi, përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë së bashku me hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit e Kosovës ose në mënyrë të pavarur dhe përmes masave duke përfshirë, nëse ka nevojë, krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë;

Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjykatësve dhe prokurorëve 2008/03-L053, e zbatueshme deri më 31 maj 2014 (më tutje si: Ligji mbi kompetencat)

#### Neni 11

Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it për krimet e motivuara nga urrejtja

11.1 Në çdo kohë gjatë procedurës dhe në pajtim me kryeprokurorin e EULEX-it, prokurorët e EULEX-it mund të marrin përgjegjësi për çdo hetim a ndjekje penale të çdo vepre penale, përfshirë këtu veprat penale kundër personave apo pronës, ku viktima, prona apo objekti i veprës penale duken të jenë përzgjedhur për shkak të lidhjes, bashkimit, afërsisë, mbështetjes apo anëtarësisë së tyre të vërtetë apo të perceptuar me një grup të vërtetë apo të perceptuar të identifikuar sipas racës, origjinës kombëtare, etnike apo shoqërore, afërsisë me ndonjë pakicë kombëtare apo grup politik, gjuhës, ngjyrës, besimit, gjinisë, moshës, të metave fizike apo mentale, orientimit seksual, apo faktorëve tjerë të ngjashëm.

#### Neni 12

Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në rast të mosgatishmërisë apo paaftësisë së prokurorëve publik të Kosovës

12.1 Në çdo fazë të secilës procedurë penale, nëse një prokuror publik i Kosovës nuk është i gatshëm apo është i paaftë që të ushtrojë detyrat e tij dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rrezikojë hetimin apo ndjekjen e duhur të një vepre penale, apo kurdoherë që ekziston dyshimi i bazuar se bëhen përpjekje për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen e një vepre penale, kryeprokurori i EULEX-it ka kompetencë që të kërkojë nga kryeprokurori i zyrës kompetente që atë lëndë t'ia caktojë:

- a) një prokurori tjetër publik të Kosovës që punon në të njëjtën zyre prokuroriale,
- b) apo cilitdo prokuror të EULEX-it që do të marrë përgjegjësinë për hetimin apo ndjekjen penale përkatëse.

## **Parashtrësat nga palët**

### **Parashtrësat e EULEX-it**

Sfera e mandatit ekzekutiv i EULEX-it

28. Paneli ka kërkuar nga palët që t'i dorëzojnë komentet e tyre lidhur me atë nëse faktet kanë hyrë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it, në veçanti sa i përket nenit 3 par. (d) të veprimit të përbashkët (shih par. 27 më sipër).
29. EULEX-i argumenton se ankesa e ankuesit nuk e vërteton se një krim me motive ndëretnike ose urrejtje ishte kryer në rastin e tij që mund ta nxiste mekanizmin, siç parashikohet në nenin 11 të Ligjit mbi Kompetencat, e cila parashikon mundësinë që prokurorët e EULEX-it të marrin përsipër lëndën (shih par. 27 më sipër).
30. EULEX-i argumenton se në mënyrë që të kualifikohen si krim me motiv urrejtje, vepra/sjellja duhet të përbëjë krim sipas ligjit penal dhe duhet të jetë kryer me një motiv bazuar në paragjykim ndër-etnik.
31. EULEX-i pranon se uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme është vepër penale në bazë të Kapitullit XXII të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2004, i cili ka qenë në fuqi në kohën e veprës së dyshuar.
32. Më tej, EULEX-i argumenton se në bazë të përshkimit të fakteve të ofruara në "raportin policor", R.Q. kishte zënë banesën, sepse ajo ishte e lirë dhe nuk janë ofruar argumente nga ankuesi për të vërtetuar një pretendim që R.Q. kishte kryer veprën penale të uzurpimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme me një paragjykim të urrejtjes etnike kundër ankuesit. Prandaj, vepra penale e uzurpimit të paligjshëm të pasurisë nuk ka prekur mandatin ekzekutiv të prokurorëve të EULEX-it.

#### Njohuria e EULEX-it mbi rastin

33. Sa për pyetjen nëse EULEX-i ka qenë në dijeni rreth rastit dhe nëse është kryer ndonjë hetim përkatës paraprak, EULEX-i pohon se prokurorët e EULEX-it nuk kanë qenë në dije për atë. Prokurorët e EULEX-it nuk kanë qenë të informuar deri në gusht të vitit 2012 rreth ndonjë ankese apo raporti të paraqitur nga ankuesi. Asnjë dokument që mban këtë numër të lëndës nuk ju është komunikuar prokurorëve të EULEX-it.
34. EULEX-i pohon se dosja që posedon zyra e kryeprokurorit të EULEX-it lidhur me ankesat që janë paraqitur në atë zyrë, përmban një memorandum nga kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it për shefin e gjyqësisë së EULEX-it rreth "*procedurave përkatëse pronësore të iniciuara*" nga ankuesi. Ky memorandum së pari është komunikuar në zyrën e kryeprokurorit të EULEX-it më 24 shkurt 2012 nga zyra e shefit të gjyqësisë, por jo vetë ankesa.

#### Shkelja e dyshuar e të drejtave të ankuesit

35. EULEX-i argumenton se një interpretim i arsyeshëm në përputhje me mandatin e EULEX-it i ndihmës për institucionet e sundimit të ligjit të

Kosovës është se do të kërkohet dëmshpërblim së pari brenda sistemit ligjor të Kosovës duke lejuar që të përdoren mjetet dhe mekanizmat në dispozicion brenda kuadrit të tij ligjor.

36. EULEX-i argumenton se ankuesi nuk ka arritur të ofroj elementet që do të lejonin të vërtetohej ekzistencën e diskriminimit në bazë të qasjes së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Jo vetëm që sjellja e EULEX-it nuk mund të konsiderohet se përbën shkelje të dispozitave të KEDNJ-së, mirëpo ajo sjellje e tij ishte gjithashtu në pajtim me mandatin e tij të ndihmës për institucionet e sundimit të ligjit të Kosovës dhe me ligjin mbi kompetencat.

Trajtimi i ankesave nga EULEX i ankesave që janë parashtruar nga ankuesi

37. Paneli ka kërkuar nga EULEX-in që të komentoj se si EULEX-i garanton se ankesat relevante të dërguara në EULEX janë shpërndarë me autoritetet e prokurorisë në kohën e duhur. EULEX-i pohon në përgjigjen e vet se të gjitha komunikimet në EULEX janë kanalizuar përmes zyrës së shefit të stafit drejt njësive përkatëse, me përjashtim të komunikimeve të marra drejtpërdrejtë nga gjykatësit apo prokurorët e EULEX-it, të cilat bien vetëm nën përgjegjësinë e divizionit ekzekutiv.
38. Zyra e shefit të stafit vlerëson cilat zyra të EULEX-it janë më të duhura për të përgatitur ndonjë përgjigje personit me të cilin zhvillohet korrespondenca dhe kërkon nga personi i caktuar të përgatis një përgjigje. Zyrat përkatëse, siç janë zyra e shefit të divizionit ekzekutiv, marrin korrespondencën në kopje, varësisht nga natyra e ankesës. Zyrat që marrin kopje të njëjtë shpeshherë ofrojnë të dhëna apo opinione lidhur me lëndën në fjalë. Të gjitha hapat në këtë procedurë janë të regjistruara në zyrën e regjistrimit të shefit të stafit. Përfundimisht, përgjigjja është dërguar nga zyra përkatëse, qoftë drejtpërdrejtë tek personit me të cilin zhvillohet korrespondenca, për shembull në rastin e kërkesës për marrjen përsipër, apo përmes zyrës së shefit të stafit.

#### **Përgjigja e ankuesit ndaj vërejtjeve të ShM-së**

39. Në thelb, thuhet se R.Q., i cili ka uzurpuar banesën e tij në mënyrë të paligjshme mbrohet nga anëtarët e policisë së Kosovës. Në veçanti, ankuesi kritikon mosveprimin e policisë së Kosovës, si dhe dështimin e prokurorit publik të Kosovës për të vepruar me vendosmëri.
40. Më tej, ankuesi pohon se në kundërshtim me argumentin e EULEX-it se deri në gusht të vitit 2012 prokurorët e EULEX-it nuk kanë qenë në dijeni rreth ndonjë ankese të akuzës penale të paraqitur prej tij, ai vetëm se kishte kontaktuar EULEX-in përmes postës elektronike më 29 nëntor 2009, mirëpo nuk kishte marrë përgjigje. Kontaktet e tij të mëtejshme me EULEX-in nuk kishin dhënë ndonjë rezultat.



41. Është pohuar se EULEX-i ka filluar të veproj vetëm pasi Paneli e kishte komunikuar lëndën tek ShM për t'i ofruar komentet e tij.
42. Më tej, ankuesi pohon se përderisa gjykata ka dënuar R.Q. tre muaj burgim me kusht, banesa e tij është dëmtuar rëndë dhe se ankuesi nuk pret të marrë kompensim për dëmet që ka pasuar.
43. Përderisa në parashtrirat e tij të datës 9 shkurt 2014, ankuesi ka deklaruar se *“unë ju kërkoj që mos të merrni masa kundër EULEX-it”, ajo është sqaruar më 28 maj të vitit 2008 se “nuk dëshiroj ta tërheq ankesën. Përkundrazi, dëshiroj që Paneli ta shqyrtoj lëndën dhe të ofroj rekomandime EULEX-it, në mënyrë që të mos përsëriten rastet e tilla”.*

## **Ligji**

44. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
45. Paneli tashmë ka konstatuar se veprimet e prokurorëve të EULEX-it apo të policisë të ndërmarra brenda kontekstit të hetimit penal janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovës dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih për shembull Z kundër EULEX-it, 2012-06, 10 prill 2013, në par. 32; W kundër EULEX-it, 2011-07, 5 tetor 2012 në par. 21; Hoxha kundër EULEX-it, 2011-18, 23 nëntor 2011 në par. 22; Slobodan Martinović kundër EULEX-it, 2011-11, 23 nëntor 2011 në par. 16).
46. Paneli më tutje ka konstatuar se veprimet ose mosveprimet e prokurorëve gjatë fazës hetimore të procedurës penale nuk mund të konsiderohen se janë bërë në kuadër të "procedurave juridike" (shih Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, par. 64). Në këtë aspekt, Paneli ka konstatuar se “veprimet dhe mosveprimet e prokurorëve të EULEX-it [...] para ngritjes së aktakuzës mund të bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it” (shih Z kundër EULEX-it, 2012-06, 10 prill 2013 në par.33; Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, par 93).
47. Rasti i tanishëm ka të bëjë me veprimet dhe mosveprimet e dyshuara të prokurorëve të EULEX-it në fazën para-hetimore. Në këtë drejtim, nuk është ofruar ndonjë argument se lënda në parim nuk hyn në kuadër të juridiksionit të Panelit.
48. EULEX-i thekson se uzurpimi i banesës së ankuesit nga R.Q. në asnjë rast nuk ka përbërë ndonjë krim të motivuar nga urrejtja dhe për këtë arsye nuk hyn në kuadër të mandatit të EULEX-it.
49. Paneli në këtë drejtim konstaton se EULEX-i nuk e ka komentuar pretendimin e ankuesit se faktet e rastit kanë përbërë diskriminim ndaj

tij nga ana e policisë së Kosovës dhe prokurorëve të Kosovës dhe se refuzimi i tyre për të vazhduar me padinë e tij e kishte penguar atë që të ketë qasja në një zgjidhje efektive.

50. Paneli ka theksuar se nuk është detyrë e vetja që të vlerësoj si të tillë cilësinë e vendimit të prokurorisë, në lidhje me fillimin e hetimeve ose marrjen përsipër të lëndëve nga prokurorët e EULEX-it prej prokurorëve të Kosovës. Megjithatë, duket se nuk është marrë ndonjë vendim zyrtar në lidhje me fillimin e ndonjë hetimi.
51. Paneli konstaton se nga EULEX-i është paraqitur që prokurorët e EULEX-it *“nuk kanë qenë dhe ende nuk janë në posedim të informacionit të nevojshëm lidhur me këtë rast” (krahasoni par. 33 më sipër)*. Prandaj, Paneli nuk mund të pranojë konkluzionin *“se sipas vlerësimit të bërë nga zyra e kryeprokurorit të EULEX-it në përgjigjen e tij lidhur me çështjet e ngritura nga Paneli që i janë referuar asaj zyre nga ana e zyrës ligjore dhe të drejtave të njeriut të EULEX-it, shkeljet e pretenduara nuk mund të kategorizohet si krime të motivuara nga urrejtja”* (shih par. 29-32 më sipër).
52. Paneli konsideron se në bazë të parashtrimeve të palëve, ankesa ngrit çështjet serioze faktike dhe ligjore që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut në lidhje me nenet 13 dhe 14 të KEDNj-së, si dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNj-së, që për vendosjen e të cilës kërkohet shqyrtimi i meritave të ankesës.
53. Prandaj, Paneli konkludon se ankesa nuk është e pabazuar dhe hyn në kuadër të juridiksionit të Panelit. Nuk është vërtetuar ndonjë arsye tjetër për ta shpallur atë të papranueshme.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli, njëzëri,

**SHPALL TË PRANUESHME** ankesat, pa paragjykuar bazueshmërinë, në lidhje me shkeljet e dyshuara sa i përket neneve 13 dhe 14 të KEDNj-së, si dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNj-së; dhe

**FTON** shefin e Misionit dhe ankuesin që në parashtrirat e tyre, nëse zgjedhin për të bërë një gjë të tillë, t'i trajtojnë çështjet e identifikuar në këtë vendim dhe secilën çështje tjetër që palët e konsiderojnë të rëndësishme rreth meritave të kësaj lënde, të cilat deri më tani nuk janë trajtuar në parashtrirat e tyre.

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda Mierzevska  
Kryesuese